


# KOMISIONERI

për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale

Revista nr. 8



## INFORMIM DHE PRIVATËSI



**41<sup>ST</sup> INTERNATIONAL CONFERENCE**  
OF DATA PROTECTION AND PRIVACY COMMISSIONERS  
Tirana, Albania





Në foto nga e majta në të djathtë: z. Raymund Enriquez Liboro, Komisioner i Filipineve; z. Daniel Therrien, Komisioner i Kanadasë; z. Besnik Dervishi, Komisioner i Shqipërisë; znj. Elizabeth Denham - Presidente e Komitetit Ekzekutiv dhe Komisionere e Informimit të Britanisë së Madhe; z. Wojciech Wiewiórowski, Mbikëqyrësi Evropian i Mbrojtjes së të Dhënave; znj. Elizabeth Hampton, Zv/komisionere e Australisë dhe z. Francisco Javier Acuña Llamas, Komisioneri i Meksikës, në cilësinë e vëzhguesit, si Autoriteti organizator i Konferencës Ndërkombëtare në 2020.

Komiteti Ekzekutiv i Konferencës së 41-të Ndërkombëtare të Komisionerëve të Mbrojtjes së të Dhënave dhe Privatësisë (ICDPPC) zhvilloi në Tiranë, më 20 tetor 2019, mbledhjen e tij të 55-të.



Në këtë mbledhje u diskutua për detajet organizative dhe përmbajtjen e Sesionit të Mbyllur të Konferencës. Komiteti Ekzekutiv është forumi drejtues më i lartë dhe koordinues i veprimtarisë së ICDPPC.

Ceremonia e Mirëseardhjes për delegatët e Sesionit të Mbyllur të Konferencës së 41-të Ndërkombëtare ICDPPC.





**Nga Fjala e Komisionerit, z. Besnik Dervishi, në hapjen e punimeve të Sesionit të Mbyllur të Konferencës së 41-të Ndërkombëtare - ICDPPC\***

“Ndhem i nderuar për çeljen në Tiranë të punimeve të Sesionit të Mbyllur të Konferencës së 41-të Ndërkombëtare të Komisionerëve të Mbrojtjes së të Dhënave dhe Privatësisë.



Nuk mund ta fsheh se gjatë përgatitjeve ka pasur momente ku për shkak të ngarkesës, së bashku me kolegët e mi, kam menduar se mbase morëm përsipër diçka më të madhe se sa mund të mbanin shpatullat tona.

Por më besoni, prezenca juaj, më shumë se 200 përfaqësues të Autoriteteve të Mbrojtjes së të Dhënave apo të tjerë që japin edhe ata kontributin e tyre në këtë fushë, nga të gjithë skajet e globit, përveç përgjegjësisë, më japin një kënaqësi të pamasë.

Uroj që diskutimet dhe vendimmarrjet e pritshme, gjatë këtij sesioni, të jenë sa më të suksesshme, në mënyrë që ne të mbetemi gjatë në memorien e Konferencës si vendi ku u morën vendime strategjike lidhur me të.

Zyra e Komisionerit vitin e kaluar festoi 10 vjetorin e krijimit të saj. Nuk ka qenë e lehtë të mund të ndërtohet një institucion nga e para, në një terren ku mbrojtja e të



dhënave personale, ashtu si dhe të drejtat dhe liritë themelore të njeriut, filluan të ndërtohen e konsolidohen vetëm pas vitit 1990.

Sot kemi një Autoritet të vogël, të një vendi të vogël, por që në modestinë e tij, ka vullnetin dhe dëshirën për të bërë më shumë se sa mundësitë.”

\*21 tetor 2019





**Nga Fjala e znj. Elizabeth Denham, Presidente e Komitetit Ekzekutiv të ICDPPC dhe Komisionere e Informimit të Britanisë së Madhe\***

“Kam përshtypjen se Konferenca e këtij viti do të jetë një prej atyre më përcaktuese në historinë tonë dhe në fakt, ka nevojë të jetë kështu.

Ne jetojmë në një epokë ku të dhënat dhe privatësia, në erën e teknologjive më të fundit, të tilla si ajo e survejimit apo e njohjes së fytyrës, ku transparenca dhe drejtësia në pritshmëritë tona shkojnë paralel. Kjo është detyra që duhet të bëjmë ne, të mbikëqyrim zbatimin e kësaj të drejte. Këto janë çështje multietnike dhe ndërkombëtare, si asnjë herë më parë.”

**\*21 tetor 2019**





**Nga Fjala e z. Gramoz Ruçi,  
Kryetar i Kuvendit  
të Republikës së Shqipërisë\***

“Autoritetet që ju drejtoni janë një mburojë e rëndësishme dhe e domosdoshme për qytetarët, për mbrojtjen e lirisë së tyre.

Asnjë konventë ndërkombëtare, Kushtetutë apo Kod, nuk ka vlerë nëse ju, Autoritetet mbikëqyrëse të mbrojtjes së të dhënave nuk bëheni garantë e gardianë të tyre.



Ju, por edhe ne, politikëbërësit dhe ligjvënësit, po përballemi me sfida të rëndësishme të zhvillimeve të sotme globale. Demokratizimi i mediave dhe demokratizimi i teknologjisë, si të mira publike për qytetarët, mund të shndërrohen në të kundërtën e tyre dhe të sfidohen nga demokratizimi i dhunës.

Është kjo arsyeja që duhet të na nxisë të hartojmë, zbatojmë e monitorojmë politika dhe ligje që garantojnë të drejtat e privatësisë dhe mbrojtjes së të dhënave, si një premisë për mbrojtjen e qytetarëve dhe të individualitetit të tyre.”

**\*21 tetor 2019**

<https://www.parlament.al/News/Index/8663>





Në dy ditët e zhvillimit të Sesionit të Mbyllur, Konferenca diskutoi dhe miratoi 6 rezoluta, të cilat adresojnë disa prej problematikave më të mprehta sot në botën digjitale:

1. Rezolutën për drejtimin strategjik të Konferencës - e cila i ka hapur rrugën reformimit dhe funksionimit më kompakt të kësaj organizate në të ardhmen.

2. Rezolutën për promovimin e instrumenteve të rinj dhe afatgjatë dhe për përpjekjet e vazhdueshme ligjore për bashkëpunim efektiv ndërkufitar.



3. Rezolutën ndërkombëtare për privatësinë, si një e drejtë themelore e njeriut dhe parakusht për ushtrimin e të drejtave të tjera.

4. Rezolutën për mbështetjen dhe lehtësimin e bashkëpunimit rregullator mes Autoriteteve të Mbrojtjes së të Dhënave dhe Autoriteteve të Mbrojtjes së Konsumatorit e Konkurrencës për të arritur standarde të larta të mbrojtjes së të dhënave në ekonominë digjitale.

5. Rezolutën për të adresuar rolin e gabimit njerëzor në shkeljen e të dhënave personale.

6. Rezolutën për median sociale dhe përmbajtjen e dhunshme ekstremiste në internet.

Konferenca pranoi në rradhët e saj 4 Autoritete të rinj nga Kili, Gaboni, San Marino dhe Sao Tome e Principe, ndërsa në rolin e vëzhguesit Komisionerin e Mbrojtjes së të Dhënave të Organizatës për Bashkëpunim Ekonomik dhe Zhvillim (OECD).







**GPA**

Global Privacy Assembly

Konferenca e 41-të, Ndërkombëtare - ICDPPC, shënon nisjen e një faze të re ndërveprimi për Autoritetet e mbrojtjes së të dhënave nga mbarë bota. Ndryshimi i emërimit të organizatës nga “Konferenca Ndërkombëtare” në “Asambleja Globale e Privatësisë – GPA”, është guri i themelit të një reforme tërësore në organizimin, funksionimin dhe koordinimin e saj të brendshëm në të ardhmen.



Konferenca rizgjodhi në detyrën e Presidentes së Komitetit Ekzekutiv për një mandat 2-vjeçar, znj. Elizabeth Denham, Komisioneren e Informimit të Britanisë së Madhe. Ndërsa anëtarë të këtij forumi për periudhën 2019-2020 janë: znj. Marguerite Ouedraogo Bonane, Komisionere e Burkina Faso; znj. Angelene Falk, Komisionere e Australisë; z. Raymund Enriquez Liboro, Komisioner i Filipineve; z. Eduardo Bertoni, Komisioner i Argjentinës; z. Besnik Dervishi, Komisioneri i Shqipërisë; z. Francisco Javier Acuña Llamas, Komisioneri i Meksikës, Autoriteti organizator i Konferencës në 2020 dhe në cilësinë e vëzhguesit, John Edwards, Komisioneri i Zelandës së Re, Autoriteti organizator i Konferencës në 2021.

Komiteti Ekzekutiv i GPA 2019—2020







## ÇMIMET GLOBALE TË MBROJTJES SË TË DHËNAVE DHE PRIVATËSISË



Ceremonia e “Çmimeve Globale të Mbrojtjes së të Dhënave dhe Privatësisë 2019”, përbën momentin e vlerësimit të punës dhe përpjekjeve të Autoriteteve për ushtrimin e mandatit të tyre ligjor. Në Tiranë u mbajt edicioni i 3-të i kësaj ceremonie.

Fitues në kategorinë ‘Edukimi dhe Ndërgjegjësimi i Publikut’ u shpall iniciativa e Autoritetit të Kantonit të Zyrihut në Zvicër, për fushatën njohëse për fëmijët e moshave 4-9 vjeç.

Në kategorinë ‘Zgjidhja e mosmarrëveshjeve dhe zbatimi i ligjit’ fitues u shpall Autoriteti neozelandez, për hetimin e zhvilluar në ministrinë e Zhvillimit Social të këtij vendi.

Në kategorinë ‘Inovacioni’ fitues u shpall Mbikëqyrësi Evropian i Mbrojtjes së të Dhënave, për iniciativën e lançimit të një faqeje në internet, e cila shërben për realizimin e hetimit online.

Autoriteti spanjoll u shpall fitues në dy kategori, atë të ‘Përgjegjshmërisë’ dhe ‘Çmimit të Publikut’, për projektin e një pyetëso online, i cili u shërben, kryesisht, ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme, që të përmbushin detyrimet ligjore në veprimtarinë e tyre.

Për herë të parë është vendosur edhe akordi i një çmimi të 6-të, nga organizatori i Konferencës. Këtë vit, ishte nder për Komisionerin shqiptar dhe për të gjithë anëtarësinë e organizatës, që çmuan kontributin e rëndësishëm, më shumë se 20-vjeçar, të Giovanni Buttarellit në këtë fushë, ish-Mbikëqyrësin e Evropian të Mbrojtjes së të Dhënave, pas ndarjes së tij nga jeta në muajin gusht 2019.






## PROGRAMI SOCIAL I KONFERENCËS SË 41-të NDËRKOMBËTARE

Vizitë në Muzeun “BunkArt 1”  
21 tetor 2019



Pritja e Mirëseardhjes për pjesëmarrësit në Sesionin e Hapur të Konferencës së 41-të Ndërkombëtare, mbajtur në mjediset e Muzeut Historik Kombëtar.

**22 tetor 2019**



Nga performanca e Ansamblit Popullor në Darkën Gala për pjesëmarrësit në Sesionin e Hapur të Konferencës së 41-të Ndërkombëtare, në mjediset e Pallatit të Kongreseve.

**23 tetor 2019**



## Nga Fjala e Komisionerit, z. Besnik Dervishi, në nisjen e punimeve të Sesionit të Hapur të Konferencës së 41-të Ndërkombëtare - ICDPPC\*

“Mund të mendohet se jemi në një moment pasigurie sa i përket zhvillimeve gjeopolitike, dhe në një kohë krize për planetin tonë, ku njerëzit janë të lidhur me njëri-tjetrin si kurrë më parë.

Por këto lidhje, kryhen me ndërmjetësimin e palëve të treta. Këto palë të treta mund të jenë shumë të fuqishme, në fakt. Ato kontrollojnë pjesën më të madhe të të dhënave të globit.



Këto lidhje dhe të dhënat personale përbëjnë interes për qeveritë - sidomos, ato qeveri të cilat duan të kontrollojnë popujt e tyre. Prandaj, ne si Autoritete të mbrojtjes së të dhënave, duhet të sigurohemi që pushteti të ushtrohet me përgjegjshmëri.

Mbase nuk do të biem dakord mbi gjithçka, por ky është një moment unik për reflektim të singertë mbi problematikat më të mëdha, me të cilat në si shoqëri përballemi, për të reflektuar sesi mund të edukojmë publikun që të ketë më shumë kontroll mbi jetët e tyre digjitale.”

**\*23 tetor 2019**

<https://www.idp.al/2019/10/23/fjala-e-komisionerit-z-besnik-dervishi-ne-ceremonine-e-nisjes-se-sesionit-te-hapur-te-konferences-se-41-te-nderkombetare-icdppc/>

## Nga Fjala e znj. Elizabeth Denham, Presidente e Komitetit Ekzekutiv të ICDPPC dhe Komisionere e Informimit të Britanisë së Madhe\*

“Kjo Konferencë zhvillohet në një kohë kyçe. Konferenca e parë u zhvillua në vitin 1979 dhe ndërkohë, 40 vjet më pas, e kemi kuptuar se privatësia është shumë e rëndësishme.

I kemi parë këto ndryshime, sidomos, 2 vitet e fundit, njerëzit presin shumë më shumë informacion për mënyrën se si përpunohen të dhënat e tyre personale.



Jam shumë krenare t’ju them se kemi bërë shumë punë gjatë kësaj jave, për të arritur në një marrëveshje, të cilën unë do ta konsideroja historike, për një bashkëpunim rregullator më të madh ndërkombëtar dhe për standarde më të larta të mbrojtjes së të dhënave personale.”

**\*23 tetor 2019**

<https://globalprivacyassembly.org/opening-remarks-from-41st-icdppc-open-session/>







**Nga Fjala e Kryeministrit, z. Edi Rama, në nisjen e punimeve të Sesionit të Hapur të Konferencës së 41-të Ndërkombëtare - ICDPPC\***

“Thjesht dëshiroj të them, së pari, fale-minderit Komisionerit, e dinë të gjithë që unë nuk shquhem për përgëzime dhe komplimente dhe jo vetëm sepse më pëlqen ai, por vërtet sepse ka bërë një punë të shkëlqyer.

Sot, në Shqipëri e gjejmë veten në një moment krejtësisht tjetër sa i përket mbrojtjes së të dhënave personale dhe privatesisë.

Pavarësisht se jemi në një moment komplet tjetër dhe kemi ecur përpara, gjithsesi, ky vend në të cilin ndodhemi është ende vulnerabël dhe gjithsesi, unë e vlerësoj shumë, njohurinë, ekspertizën që sjell ky rrjet që ju keni.

*“Another pleasant Albanian surprise – not your traditional perfunctory greeting. Thank you Edi Rama. #ICDPPC2019”.*

*“The house of an Albanian belongs to God and guests. And God doesn’t always show up, so guests are gods”.*

*“Powerful word from #Albania PM Edi Rama: Our #privacy and #data are under attack. We are living in an age of shamelessness, and that is the battle we must fight.”*

*“Great remarks form Albanian Prime Minister Edi Rama at the International Conference of Data Protection and Privacy Commissioners. A call to action to protect privacy and also enjoy great Albanian hospitality.”*



Sepse gjithçka ka të bëjë me njohuritë dhe në lidhje me gjërat që ne kemi, ne që prej shumë e shumë kohësh na është dashur që të ishim një vend i pasur, por në lidhje me ato gjëra që dimë, ne jemi të ndërgjegjshëm për faktin që kemi ende shumë për të mësuar dhe kjo është dhe pjesa më e rëndësishme e asaj hapje që ne po bëjmë kundrejt botës dhe e kemi bërë që në vitin 1990 me kanalet tona të bashkëpunimit, me të gjithë partnerët tanë ndërkombëtare në të gjitha nivelet, që nga organizatat ndërkombëtare, në konferenca si kjo e juaja, apo nga burime të tjera njohurish dhe ekspertize.

Ndaj faleminderit që keni ardhur! Fale-minderit që keni sjellë këtu përvojën tuaj, ekspertizën tuaj, njohuritë tuaja. Unë jam i sigurt se që sot e tutje, kur të ktheheni në vendet tuaja, ju do t’i shtoheni listës së atyre personave, të cilët do t’u thonë mi-qve, kur t’ju pyesin “Ke qenë në Shqipëri?”, apo “Çfarë dreqin doje në Shqipëri?”, “Si qenke kthyer shëndoshë e mirë?” dhe ju do t’u thoni atyre, “Unë kam parë gjëra që ju, o njerëz, nuk keni për t’i besuar.”

**\*23 tetor 2019**







**Paneli I**

***Global convergence in data protection law: where are we converging and what progress are we making towards common standards? / Konvergjencia globale në ligjin për mbrojtjen e të dhënave: ku po konvergojmë dhe çfarë progresi po bëjmë drejt standardeve të përbashkëta?***

Moderator:

- ◆ Graham Greenleaf - Profesor, Universiteti i Uellsit të Ri Jugor, Australi

Panelistë:

- ◆ Chawki Gaddès - Komisioner i Tunizisë, President i Shoqatës Frankofone të Mbrojtjes së të Dhënave (AFAPDP)
- ◆ Bruno Gencarelli - Kreu i Njësisë për Mbrojtjen e të Dhënave, Komisioni Evropian
- ◆ Felipe Rotondo - Anëtar i Këshillit Ekzekutiv, Autoriteti i Uruguait
- ◆ Stephen Kai-yi Wong – Komisioner i Hong Kongut
- ◆ Jan Kleijssen - Drejtor i Drejtorisë së Shoqërisë së Informacionit dhe Aksionit Kundër Krimit, Këshilli i Evropës
- ◆ Noboru Yamaji - Komisioner i Bashkëpunimit Ndërkombëtar, Autoriteti i Japonisë



**Paneli II**

***Addressing the global privacy challenge of data driven business models / Adresimi i sfidës globale të privatësisë për modelet e bizneseve që udhëhiqen nga të dhënat***



**Marc Rotenberg, Drejtor i Përgjithshëm, “Qendra e Informimit të Privatësisë Elektronike” (EPIC), SHBA**



Moderator:

- ◆ Elizabeth Denham - Presidente e Komitetit Ekzekutiv ICDPPC, Komisionere e Informimit të Britanisë së Madhe

Panelistë:

- ◆ Carole Cadwalladr - Gazetare e “The Guardian”, Britani e Madhe
- ◆ Simon Hania - Drejtuesi i Mbrojtjes së të Dhënave të Uber për Evropën
- ◆ John Edwards - Komisioner i Zelandës së Re
- ◆ Sally Hubbard - Drejtor, “Instituti i Tregjeve të Hapura”, SHBA







***Folës kryesor***

***Brad Smith - Presidenti i Microsoft, SHBA***



***Eduardo Berton – Komisioneri i Argjentinës***



***Paneli III***

***Data protection and competition as converging digital regulation: from theory to practice / Mbrojtja e të dhënave dhe konkurrenca si konvergues i rregullores digjitale: nga teoria në praktikë***



**Moderator**

- ♦ Wojciech Wiewiórowski – Mbikëqyrësi Evropian i Mbrojtjes së të Dhënave (EDPS)

**Panelistë**

- ♦ Ulrich Kelber – Komisioner i Gjermanisë
- ♦ Orla Lynskey – Lektore, Shkolla Ekonomike e Londrës
- ♦ Rohit Chopra – Komisioner, Komisioni Federal i Tregtisë, SHBA
- ♦ Giuseppe Busia – Sekretar i Përgjithshëm, Autoriteti i Italisë
- ♦ Maria Ioannidou – Komisionere e Konkurrencës, Greqi





**Folës kryesor**

***Jamie Bartlett - Gazetar dhe shkrimtar,  
Britani e Madhe***



***Marguerite Ouedraogo Bonane -  
Komisionere e Burkina Faso***



***Erion Veliaj - Krytari i Bashkisë,  
përshëndet punimet e Sesionit të Hapur  
të Konferencës Ndërkombëtare***



***Peter Hustinx - Bashkë-drejtues i  
Komitetit Këshillimor të Programit  
ICDPPC 2019***




**Folës kryesor**

***Christopher Docksey - Drejtor i  
Përgjithshëm Nderi, EDPS***



**Paneli IV**

***Accountability – the global bridge to support high standards of data protection? / Përgjegjshmëria - urë globale për të mbështetur standardet e larta të mbrojtjes së të dhënave?***



**Moderator:**

- ◆ Andrea Jelinek – Komisioner i Austrisë, Presidente e Bordit Evropian të Mbrojtjes së të Dhënave (EDPB)

**Panelistë:**

- ◆ Marty Abrams – President, Fondacioni “Përgjegjshmëria mbi Informacionin Personal”, SHBA
- ◆ Caroline Louveaux – Drejtor i Privatësisë, Mastercard
- ◆ Daniel Therrien – Komisioneri i Kanadasë
- ◆ Bertrand Du Marais – Anëtar i Bordit, Autoriteti i Francës
- ◆ Ailidh Callander – Juriste, Organizata “Privacia Ndërkombëtare”, SHBA

**Paneli V**

***Future challenges for data protection authorities and data protection officers / Sfidat e së ardhmes për autoritetet e mbrojtjes së të dhënave dhe nëpunësit e mbrojtjes së të dhënave***



**Moderator:**

- ◆ Trevor Hughes – President i Shoqatës Botërore të Profesionistëve të Privatësisë (IAPP), SHBA

**Panelistë:**

- ◆ Julie Brill – Zv/president i Microsoft, SHBA
- ◆ Stephen Kai-yi Wong – Komisioner i Hong Kongut
- ◆ Simon McDougall – Drejtor, Autoriteti i Britanisë së Madhe
- ◆ Kalinda Raina – Zv/presidente dhe Drejtoresh e Privatësisë, LinkedIn, SHBA
- ◆ Alexandra Jaspas-Leeuw—Drejtoresh, Autoriteti Belg



**Raymund Enriquez Liboro -  
Komisioner i Filipineve**



**Francisco Javier Acuña Llamas -  
Komisioner i Meksikës, Autoriteti  
organizatori i Konferencës së 42-të  
Ndërkombëtare**

**Nga Fjala e mbylljes së  
zgj. Elizabeth Denham, Presidente  
e Komitetit Ekzekutiv të ICDPPC dhe  
Komisionere e Informimit të Britanisë së  
Madhe\***

“Më takon mua si kreu i Komitetit Ekzekutiv të falënderoj Autoritetin organizator për këtë Konferencë të mrekullueshme, për mikpritjen e ngrohtë dhe për kohën e shkëlqyer këto ditë.



Kjo ishte me të vërtetë një Konferencë globale. Dua t’ju citoj një proverb të vjetër shqiptar: “ai që qëndron përpara një pemë të lartë, mbulohet nga hija e saj”. Organizata jonë është kjo pemë!

Anëtarësia jonë sot përbëhet nga më shumë se 120 Autoritete të ndryshme, nga çdo kënd i botës. Unë mendoj se progresi që kemi arritur këtë javë do të vazhdojë të na udhëheqë dhe të përfitojmë nga hija e Konferencës.

Me këtë rast, kam kënaqësinë të ndaj me ju lajmin se ndryshimi i emërimit të organizatës në “Asambleja Globale e Privatësisë”, është një pikënisje e re dhe që do të sigurojë se komuniteti ynë të mbështetet dhe të funksionojë përgjatë gjithë vitit dhe jo nga Konferenca në Konferencë, që të kemi një zë edhe më të fortë.”







**Nga Fjala e Komisionerit,  
z. Besnik Dervishi, në mbylljen e  
punimeve të Sesionit të Hapur  
të Konferencës së 41-të  
Ndërkombëtare - ICDPPC\***

“Më mbetet të falënderoj në mënyrë të veçantë të gjithë ju që morët pjesë në këtë Konferencë.

Vlerësim të veçantë, duke shpresuar që nuk ju kemi zhgënjyer, për ata që besuan tek ne për organizimin e Konferencës.

Në fund, do të më lejoni të them dy fjalë edhe për ata me të cilët gjatë këtyre muajve kam ndarë përgjegjësinë e organizimit të Konferencës, lodhjen dhe tensionin e punës, stafin e Zyrës së Komisionerit.

Shumë më kanë pyetur se pse dhe si kërkuat dhe arritët të siguronit organizimin e Konferencës. Me vullnet, shpirt iniciative dhe punë të palodhur, duke ju kërkuar ndjesë për çdo inkoveniencë. Me mbështetjen e kolegëve dhe të miqve tanë që “rrezikuan” duke na e besuar atë. Por mbi të gjitha, për të treguar se edhe një Autoritet i vogël, i një vendi të vogël, me problemet e tij, i dënuar me vetëmbyllje për dekada me rradhë, por me një dëshirë të madhe për zhvillim, mund t’ia dalë. E si mund të mos e duash këtë vend dhe këtë popull mikpritës dhe me një zemër të madhe gjatë gjithë historisë së tij?!”



**\*24 tetor 2019**

<https://www.idp.al/2019/10/24/fjala-e-komisionerit-z-besnik-dervishi-ne-mbyllje-te-konferences-se-41-te-nderkombetare-icdppc/>







Si forumi më i rëndësishëm i bashkëpunimit, koordinimit dhe ndërveprimit në fushën e mbrojtjes së të dhënave dhe privatësisë së individit mes Autoriteteve, botës akademike, biznesit, shoqërisë civile dhe medias, në punimet e Sesionit të Hapur të Konferencës morën pjesë më shumë se 700 delegatëve nga gjithë bota.

Ky takim i përvitshëm u mundëson profesionistëve të mbrojtjes së të

dhënave personale dhe privatësisë, jo vetëm të shkëmbejnë përvojën dhe eksperiencën e tyre, por edhe të informohen në lidhje me aktualitetin në këtë fushë, nëpërmjet takimeve të ndryshme që emërtohen aktivitetet paralele – side events.

Mbi 25 të tilla u zhvilluan më 22, 23 dhe 24 tetor, jo vetëm në mjediset e Pallatit të Kongreseve, nga rrjete rajonale/linguistike,

grupe dhe forume të ndryshme ndërkombëtare, si: nga Këshilli i Evropës; Mbikëqyrësi Evropian i Mbrojtjes së të Dhënave; Komisioneri i Informimit të Britanisë së Madhe, Zyra e Privatësisë dhe të Drejtave Civile të Departamentit

amerikan të Drejtësisë; Komisioni Evropian dhe Rrjeti ibero-amerikan i Mbrojtjes së të Dhënave; Rrjeti Afrikan i Mbrojtjes së të Dhënave; Rrjeti Global Ligjzbatues për Privatësinë (GPEN) etj.; nga universitete të njohura, si ai Vrije i Brukselit apo ai Teknologjik i Pekinit; por dhe nga kompani të

rëndësishme si: Microsoft, Facebook, Google, OneTrust, Kelony, GSMA, Consulcesi, etj.





## Mbrojtja e të Dhënave në Ekonominë Digjitale: Vendet e treta përballë GDPR

Zyra e Komisionerit, në kuadër të Konferencës së 41-të Ndërkombëtare ICDPPC, organizoi në Qendrën për Hapje dhe Dialog (COD) aktivitetin me temë “Mbrojtja e të Dhënave në Ekonominë Digjitale: Vendet e treta përballë GDPR”.

Me hyrjen në fuqi të Rregullores së Përgjithshme të Mbrojtjes së të Dhënave Personale në BE (GDPR) në maj të vitit 2018, ndikimi është i gjerë në shumë fusha, e kryesisht, në atë të teknologjisë dhe inovacionit.

Kjo tryezë kishte si qëllim vendosjen e një dialogu për forcimin e ndërgjegjësimit dhe rritjen e gatishmërisë të të gjithë aktorëve të përfshirë në ekonominë digjitale, për t'u përballur me sfidat dhe risitë që sjell Rregullorja e Përgjithshme, duke promovuar njëkohësisht besimin e konsumatorit në tregun digjital.



Panelistët, ekspertë vendas, përfaqësues nga Autoriteti i Konkurrencës, Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, Agjencia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit, por edhe ekspertë të huaj me ekspertizë të rëndësishme në këtë fushë dhe përfaqësues nga Autoriteti zviceran për Mbrojtjen e të Dhënave Personale, sollën këndvështrimet e tyre, praktikat e dërritishme, problematikat e konstatuara dhe sugjeruan zgjidhjet e mundshme, për arritjen e përputhshmërisë legislative kombëtare me GDPR.

Nga prezantimet e mbajtura nga panelistët, ndërveprimi me auditorin dhe diskutimet e zhvilluara u konkludua, se përveç ndryshimeve në legjislacionin përkatës, për të reflektuar risitë e GDPR, me rëndësi është ndërveprimi ndërmjet aktorëve vendas që preken nga këto ndryshime.

Gjithashtu, bashkëpunimi ndërmjet Autoriteteve homologe të mbrojtjes së të dhënave personale të vendeve të treta por, edhe me ato të Bashkimit Evropian, është tejet i rëndësishëm për shkëmbimin e eksperiencave mbi hapat që po ndërmerren në kuadër të arritjes së standardeve të GDPR dhe unifikimin e praktikave në këtë drejtim me qëllim zbatimin e tyre.





**Tweet**

You Retweeted

**Gabriela Zanfir-Fortuna**  
@gabrielazanfir

#ICDPPC2019 open session kicks off with a very thoughtful speech of the Albanian commissioner, making a smooth transition from last year's conference, with a bow to @EU\_EDPS & Giovanni Buttarelli's legacy in thought (digital ethics) & organizational vision for global conferences



10:39 PM · Oct 24, 2019 · Twitter for Android

**Tweet**

You Retweeted

**Jeroen Terstegge**  
@PrivoSense

It was a great pleasure to attend #ICDPPC2019. Tirana is a really interesting city and its people were all so nice. We have to come back; time was too short. Big Thank You to @IdpAlbania for hosting the event.



10:39 PM · Oct 24, 2019 · Twitter for Android

Search Twitter

**Relevant people**

**Jeroen Terstegge**  
@PrivoSense · Follows you  
#Privacy Strategist | #DataEthics | #GDPR RAUG | #BCRS Godfather | Speaker | Partner @PrivacyMgmt | Country Leader @PrivacyFros | Privacy Chair @VNDONCW & @MKBEL

**IDP Albania**  
@IdpAl... · Follows you  
Profili zyrtar i Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale, Information and Data Protection Commissioner of Albania

**Trends for you**

Trending in Albania

#Tirana  
Visit Tirana in Tweeting about this

Show more


Terms · Privacy policy · Cookies · Ads info  
More · © 2019 Twitter, Inc.

**Tweet**

You Retweeted

**Andres Barreto G.**  
@andresbarretog

Thank you @IdpAlbania for a wonderful international conference in Tirana 🇷🇺 congratulations to the @ICDPPC2019 for the important resolutions adopted as well as the interesting agenda and debates in this @icdppc2019 hope to see you in #Mexico2020 hosted by @INAMexico #ICDPPC2019



5:13 PM · Oct 25, 2019 · Twitter for Android


**in** Search

Home My Network Jobs Messaging Notifications More Work Try Premium Free for 3 Months

**Recent**  
#icdppc2019

**Groups**  
Events  
Followed Hashtags  
#icdppc2019  
See all  
Discover more

**Grace Chen** · 3rd+  
Privacy Director · International, Anti-Financial  
2h  
Inspired by the privacy discussions in Tirana at the 41st #ICDPPC2019, convergence will bring about the development of common standards, which in turn will result in greater harmonization and interoperability of privacy laws around the globe.



12  
Like Comment Share

About · Help Center · Privacy & Terms  
Advertising · Business Services  
Get the LinkedIn app · More  
LinkedIn LinkedIn Corporation © 2019

**Tweet**

You Retweeted

**Trevor Hughes**  
@jtrevorhughes

Notable that @icdppc2019 is being held in Albania, a country that within recent memory was one of the most isolated in the world. Now, the Albanian commissioner opens a global event to discuss #privacy, AI, human rights, and more.

9:17 AM · Oct 23, 2019 · Twitter Web App

5 Retweets 14 Likes

**Tweet**

You Retweeted

**Paul Breitbarth**  
@EuroPaulB

Great turnout for the opening of the 41st International Privacy Conference. Commissioner Dervishi is welcoming delegates to Tirana. "Data protection has grown up; it's all around the world now." #ICDPPC2019



9:15 AM · Oct 23, 2019 · Twitterrific for iOS

5 Retweets 12 Likes

Search Twitter

**Relevant people**

**Paul Breitbarth**  
@EuroP... · Follows you  
Director EU Operations & Strategy @Nymity | Senior visiting fellow @expcomasticht | Privacy & Politics | My tweets, my views

**Trends for you**

Trending in Albania

#Tirana  
Visit Tirana in Tweeting about this

Show more

Terms · Privacy policy · Cookies · Ads info  
More · © 2019 Twitter, Inc.



**Mar España Marti** 34 Tweets Following

1 9 11

**Mar España Marti** @MarEspanaMarti · Oct 22  
I would like to thank the @ICDPPCSec for recognizing the labour of the @AEPD\_es. We feel honoured! #ICDPPC2019 @icdppc2019

**ICDPPC Secretariat** @ICDPPCSec · Oct 22  
Congratulations to last night's winners of the Global Privacy and Data Protection Awards 2019, celebrated at the @ICDPPC2019. The awards celebrate the achievements of the ICDPPC community. #ICDPPC2019  
Full results here [icdppc.org/winners-announ...](https://icdppc.org/winners-announ...)



1 3 20

**Mar España Marti** @MarEspanaMarti · Oct 22  
Ayer nos concedieron dos premios en los #privacyawards de la

**ICDPPC2019** 193 Tweets

**Tweet Analytics**

**ICDPPC2019** @icdppc2019  
Congratulations to the Global Privacy Awards winning authorities: Data Protection Authority of the Canton of Zurich, Switzerland; Agencia Española de Protección de Datos; Office of the Privacy Commissioner, New Zealand; European Data Protection Supervisor #icdppc2019 pic.twitter.com/5c1bZzH4Yr

<b>Impressions</b> times people saw this Tweet on Twitter	12,663
<b>Total engagements</b> times people interacted with this Tweet	456

[View all engagements](#)

**Reach a bigger audience**  
Get more engagements by promoting this Tweet!

[Get started](#)

**ICDPPC Secretariat** @ICDPPCSec · Oct 21  
The @IdnAlbania Commissioner's Award is in honour of Giovanni Buttarelli

**Tweet**

You Retweeted

**JerseyCIC** @JerseyCIC

Our Commissioners Jay Fedorak & Paul Vane & Board Member Clarisse Giroit have been reinforcing #JerseyCI contribution to global privacy @ #ICDPPC2019 in #Tirana. They're pictured with #Albania Commissioner Besnik Dervishi & host of next yr's conference in #MexicoCity.



**Relevant people**

**JerseyCIC** @JerseyCIC  
Jersey's Office of the Information Commissioner

**Trends for you**

Trending in Albania  
#Tirana  
Visit Tirana is tweeting about this

[Show more](#)


Terms: Privacy policy Cookies

**LinkedIn** Search

Home My Network Jobs Messaging

**Sally Hubbard** · 3rd+  
Director of Enforcement Strategy at Open Markets Institute | Creator & Podcas...  
2w

Til next time, Albania! It was an honor to be on a panel with two women I've admired from a distance, Elizabeth Denham, the UK Information Commissioner, and Carole Cadwalladr, the investigative journalist who exposed the Cambridge Analytica scandal, as well as co-panelists John Edwards and Simon Hania, at the 41st International Conference of Data Protection and Privacy Commissioners. And Tirana is a lovely and fascinating place to visit.



78 · 5 Comments

**Tweet**

You Retweeted

**Lauren Reid** @theprivacypro

That's a wrap on #ICDPPC2019, plenty of inspiration to carry me to next year in Mexico City when it's the Global Privacy Assembly. Time to kick off my conference shoes and go enjoy some Albanian wine 🍷



**Relevant people**

**Lauren Reid** @theprivacypro  
Privacy and data protection lawyer, pragmatic thinker and author

**Trends for you**

Trending in Albania  
#Tirana  
Visit Tirana is tweeting about this

[Show more](#)

Terms: Privacy policy Cookies

**Tweet**

You Retweeted

**Eduardo Ustaran** @EUstaran

Can I just say for the record that the coffee in #Tirana is truly good. There are many others, but that's just a good reason to come back.



**Relevant people**

**Eduardo Ustaran** @EUstaran  
Privacy and data protection lawyer, pragmatic thinker and author

**Trends for you**

Trending in Albania  
#Tirana  
Visit Tirana is tweeting about this

[Show more](#)

Terms: Privacy policy Cookies Ads info









## Përmbajtja

Konferenca e 41-të Ndërkombëtare ICDPPC, Mbledhja e 55-të e Komitetit Ekzekutiv	faqja 2
Hapja e Sesionit të Mbyllur, nga fjala e Komisionerit Dervishi	faqja 3
Hapja e Sesionit të Mbyllur, nga fjala e Komisioneres Denham	faqja 4
Hapja e Sesionit të Mbyllur, fjala e Kryetarit Ruçi	faqja 5
Përmbledhje e punimeve të Sesionit të Mbyllur	faqja 6
Zgjedhja e Komitetit të ri Ekzekutiv të GPA	faqja 7
Çmimet Globale të Mbrojtjes së të Dhënave dhe Privatësisë	faqja 8
Programi Social i Konferencës Ndërkombëtare	faqja 9
Çelja e Sesionit të Hapur, nga fjala e Komisionerit Dervishi	faqja 10
Çelja e Sesionit të Hapur, nga fjala e Komisioneres Denham	faqja 10
Çelja e Sesionit të Hapur, nga fjala e Kryeministrit Rama	faqja 11
Sesioni i Hapur, punimet e ditës së parë	faqja 12-13-14
Sesioni i Hapur, punimet e ditës së dytë	faqja 14-15-16
Përfundimi i punimeve të Konferencës, nga fjala e Komisioneres Denham	faqja 16
Përfundimi i punimeve të Konferencës, nga fjala e Komisionerit Dervishi	faqja 17
Aktivitetet paralele të Konferencës	faqja 18
Mbrojtja e të Dhënave në Ekonominë Digjitale: Vendet e treta përballë GDPR	faqja 19
Përzgjedhje e komenteve nga rrjetet sociale	faqja 20-21-22


---

### Revista “Informim Dhe Privatësi”

**Redaksia: Irma Arapi, Alketa Koja, Redi Skënderaj, Erald Mullaraj, Elinda Sulejmani.**

**Përgatitet dhe botohet nga Zyra e Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale**





**KOMISIONERI PËR TË DREJTËN  
E INFORMIMIT DHE MBROJTJEN  
E TË DHËNAVE PERSONALE**

**Rruga "Abdi Toptani", Nd. 5**

**Kodi postar 1001**

**Tiranë**

**Tel: +355 42237200**

**Nr. i gjelbër: 08002050**

**[www.idp.al](http://www.idp.al)**

**[info@idp.al](mailto:info@idp.al)**